

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga Shoqëria aksionare hoteliere-gastronomike MAKEDONIJATURIST Shkup, me seli të regjistruar në rr. Filipi i Dytë i Maqedonisë nr. 5, Shkup-Qendër, përmes avokatit Josif Filipovski nga Shkupi, në seancën e mbajtur më datë 17.08.2026, miratoi këtë:

AKTVENDIM

1.Konstatohet se përqendrimi me të cilin Shoqëria aksionare hoteliere-gastronomike MAKEDONIJATURIST Shkup, me seli të regjistruar në rr. Filipi i Dytë i Maqedonisë nr. 5, Shkup-Qendër, Shkup, do të fitojë të drejtën e qirasë afatgjate (shfrytëzimit) të pronës së paluajtshme që paraqet hotel-pjesë e kompleksit sportiv „Jane Sandanski“ i cili menaxhohet nga Shoqëria për sport dhe rekreacion „QENDRA SPORTIVE JANE SANDANSKI“ SHPKPNj Shkup, me seli të regjistruar në Bulevardin „ASNOM“ nr. 1, Shkup – Aerodrom, Shkup, përmes marrëveshjes për qira të pronës, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë parandalimin, kufizimin ose shtrembërimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve, dhe **është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, në kuptim të nenit 19, paragrafi (1), pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

2.Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksë administrative për njoftimin për përqendrim në vlerë prej 6.000 den. dhe për aktvendimin në vlerë prej 30.000 den., sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për Taksat Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 151/21) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, shifra e të hyrave dhe programi 72231300.

3.Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më datë 17.07.2026, ndërsa e plotësuar më datë 24.07.2026, pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) është dorëzuar njoftimi për përqendrim me të cilin Shoqëria aksionare hoteliere-gastronomike MAKEDONIJATURIST Shkup, me seli të regjistruar në rr. Filipi i Dytë i Maqedonisë nr. 5, Shkup-Qendër, Shkup, do të fitojë të drejtën e qirasë afatgjate (shfrytëzimit) të pronës së paluajtshme që paraqet hotel-pjesë e kompleksit sportiv „Jane Sandanski“ i cili menaxhohet nga Shoqëria për sport dhe rekreacion „QENDRA SPORTIVE JANE SANDANSKI“ SHPKPN Shkup, me seli të regjistruar në Bulevardin „ASNOM“ nr. 1, Shkup – Aerodrom, Shkup.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit që nga dita e pranimi të tij dhe, në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin për përqendrim, plotësimin dhe shtojcat e tij, konstatoi si vijon:

Veprimtaritë kryesore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

Shoqëria aksionare hoteliere-gastronomike MAKEDONIJATURIST Shkup e ka si veprimtari akomodimin hotelier në qytetin e Shkupit. Në portofolin e saj ka 4 (katër) hotele, dhe atë: Holiday Inn Shkup me 5 yje, Hotel Turist me 4 yje, Hotel Karposh me 4 yje dhe Hotel Bellevue me 4 yje, të gjitha në Shkup. Përveç hoteleve, Shoqëria aksionare hoteliere-gastronomike MAKEDONIJATURIST Shkup menaxhon edhe restorante dhe përmbajtje (salla) për kongrese në kuadër të hoteleve.

Sipas Marrëveshjes për qira të pronës të lidhur ndërmjet Shoqërisë për sport dhe rekreacion „QENDRA SPORTIVE JANE SANDANSKI“ SHPKPNJP Shkup dhe Shoqërisë aksionare hoteliere-gastronomike MAKEDONIJATURIST Shkup, Shoqëria aksionare hoteliere-gastronomike MAKEDONIJATURIST Shkup merr me qira afatgjate pronën e paluajtshme që paraqet hotel-pjesë e kompleksit sportiv „Jane Sandanski“, përkatësisht merret me qira një hotel i cili operon nën markën Hotel „Rusia“ me 4 yje në Shkup.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i paraqitur bie nën dispozitat e Ligjit, pasi i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafët (2), (3) dhe (4) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat, gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i paraqitur, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të njëjtin, pasi nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
KRYETARE

Mr. Малинка Силјановска Николиќ